

VIKTOR GJIKOLAJ

**SHIRA DHE  
YLBERE<sub>3</sub>**

**Poezi**

## QËNDRESA E FAJIT

Dhe zjarri ra në kullën me myshk  
Gjuhët e flakës u grindën në erë  
U dogjën stolitë në sëndyq  
Dhe krejt reliket me vlerë.

Në pìrgun e lartë me hi  
Ku gjithçka u kall me rrëmbim  
Kishte shpëtuar për çudi  
Fleta ku shkruhej, faji im.

Maj 1998

## SHIRA DHE YLBERE

. . . . paradite  
Shiu ra pa pra  
Konopin s'di sa herë ma lidhi në fyt  
Lumi më mbet  
Pa va...  
Varkë askund,  
Askund...

... pasdite  
Mbi shkulma  
Ylberi nguli njërin skaj.  
Pastaj  
Harkoi mbi shkrepë,  
Pyje,  
Mbi fate lidhur nyje  
E tek Shpella e Fatmirave  
U  
Thye...  
(Bujtina ishte bosh,  
Fatmirat nguteshin për t'u kthye.)

Nesër  
Paradite do të bie shi  
S  
h  
i.  
S  
h  
i  
.  
E unë pres ylberin të shfaqet  
Përsëri.

## FATI IM

Të kërkova në diell.  
Ti ,nën do rreze të rreme  
Dridheshe, si gjethja e shullanit në erë.

Desha të sajoj për ty një ombrellë  
(Pa pyetur për çmimin e saj.)  
Por shiu të kalbte gjer thellë  
Dhe kolliteshe pa shpresë  
E qaje pa faj.

Trimërova.  
Kërkova erë tropiku.  
Përtonte.  
Harrohej në shkëmbenjtë  
E ngrirë të pritjes.  
Mëkatet përgjumur vareshin  
Nëpër degë dafinash...

Në udhëkryqe provinciale u lage  
Dhe u tere në ikje- kthim  
Një poçe dheu e pjekur në shi  
Ti,  
Fati im.

## DURIMI

E vonova natën time  
Dhe durova në terr  
E sulmova me shkëlqime  
  
... E lindi një mëngjes!

## ÇUDI ME TY

Në lendenë e bardhë të gjirit tënd  
Shkrumohen sytha zambakësh  
Të sapoçelur.  
Çudibërëse kjo stinë me shi...

Në sytë e tu-ullishtë e ndezur  
Paqja u fik si pisha  
Në erë.  
Çudibërës pëllumbat e buzëqeshjes sime...

Në dy buzë që digjen shpuzë  
Avujt e mjegullt të instiktit  
Ngrijnë.  
Çudibërëse fjalët e mia të ngrohta...

Hapi yt trokon drejt territ  
E gjurmët thërrmojnë yje  
Plot vezullime,  
Çudibërëse nata ime...

Çudi me ty!

## FRASHËLIES

Ëmbël-o, ç'më ëmbëlsove, frashëlie!  
Më lëndove, më bukurove, hënëz Dangëllie.

Flakë më ndezje kur ti qeshje butësisht  
Oh! Si digjeshim nëpër dehje paqësisht.

Nëpër gjethe, nëpër bar, aft' i mbrëmjes fëshfërinte  
Zgjaste dorën hënë e artë dhe na krihte...

Bukuronim bukurisht, buzëngjitur  
Qielli qeshte ëmbëlsisht, yjëstërpikur.

Si u ndamë e më s'u pamë, frashëlie?!...  
Ç'më rri ndezur mall' i parë, prush djalërie!..

## SHPIRTI I BARIUT

Nëse nata të zë pa dalë  
Nga pishnaja  
Në pllajën e Valmorit  
Dhe yje nuk ka, as rreze hëne...  
Punë e madhe!  
Vazhdoni udhën  
Pa efshe e frikë,  
Veç mbani nga varri i bariut

Shpirti i lalë Avdiut  
Iu bën dritë.

## KROI I BARDHË

Kjo bjeshkë nuk do të ishte kaq e hirshme,  
E freskët s'do të ishte sakaq.  
Obeliskët e pishave ngulur mbi shkëmbinj  
Nuk do të ishin kaq madhështor.  
Dhia e ëgër do të ishte më e egër,  
Kjo tufë zogjsh s'do të këndonte kaq ëmbël,  
S'do të ishin kaq të bukur sytë e tu të zi  
Pa këto valë të Kroit të Bardhë  
Që sjellin shëndet e bardhësi.

Bjeshkë më bjeshkë kaloni,  
S'do të gjeni të ngjashëm,  
KROI i viseve të mia  
... i fillikatshëm.

## TE SUKA E GJOLLËVE

U laga në lashtën e mëngjesit  
Më kish marrë malli të dal te Suka e Gjollëve  
Të shoh si zbardhon Shkalla e Mullit  
Me qerpikë të lagur pabesisht prej lotëve.

Të ndiej si tringëllojnë këmborë e zile  
Shtegut që të çon nga Gurra Gjibardhë  
Të shoh si bredhin kecat kodrave jeshile,  
Ç'mall për fëmijërinë më paska marrë!

Atëbotë më pëlqen të bëhem bari  
Ta ndjell gjënë e gjallë si im ungj  
E të shkulet tufa me shpejti  
Nga kullota e ambël buzë Gurit Burgj.

E ashtu tek vërrasin e zbresin me potere  
Në mes të më fusin, të më sillen rrotull  
Veç s'do të më rrëzojë më dhia brikacelle  
Si dyzet vjet më parë, kur isha i vogël.

E nënë-shkreta prej stanit në Arë të Rubës  
Drejt meje rendi turraqit  
Në pjesën e prapme më ra me bisht të furkës:  
Shejtan! Ruaju nga dhitë!

E ndjera nënë prehet në një varr  
Nën pisha të blerta. Shpirti iu bëftë dritë!  
Tek këto gjollë kam marrë dikur një varrë  
Por... Zylo, s'më thirrën ndonjë ditë!

U laga me lashtën e mëngjesit  
Në këtë prill të vonë, i thinjur pak  
Rasa s'e solli të bëhesha bari,  
As koha të më thërrasë: plak.

2002

## KLITHMA E HESHTJES SË BARDHË

Dita

Shurdhe, zeshkane, mburracake

Pa skaj

Diellin e mban fshehur

Pas akullit të saj.

Bërryli

I drunjte në brinjët e mia

Shtyn e shfryn.

Përbindësh

Muzgu i trishtë më rri mbi krye.

Përreth meje:

Pellgje sa për të më zhytur.

Lëkurë iriqi më shtrojnë për të fjetur

Fjalë.

Sa për të më sharë...

Ditë e shurdhër:

Hapi veshët

Të dëgjosh

Klithmën e heshtjes sime

Të bardhë.

## PROTOZOT

Bash në prill.  
Qyqet: ku-ku... ku-ku...  
Kori i papagajve: ho-ho-ho!

Protozot, ç'pamë,  
Ç'kemi dëgjuar!  
Dhe sa trimëri na duhet  
Për të duruar!?

Protozot!

## NUK ISHTE VJESHTË

Kish nisur një çerdhe  
Në gjoksin tim  
Dallëndyshja që iku e më la  
Cork të vetëm.  
I kallur në heshtjen plot trishtim  
S'di për të satën herë  
Më shkelën pranverën.

N'këtë stinë zambakësh  
Erë shkretëtire nga erdhe kështu,  
Nga erdhe?!  
Zambakun e lë pa fletë  
Dhe gjoksin tim pa çerdhe.

Nuk ishte vjeshtë...

**1986**

## PESHA

E pyetën kampionin :  
Në cilën garë,  
Në cilin vit  
Peshën më të rëndë  
Keni ngritur?

I shtangur  
Shtangisti tha duke qarë:  
Më 1 9 9 9-tën,  
Kur ngrita nga dheu  
Një foshnje të vrrarë...

Ishte  
Gjakovar.

*Gjakovë, 6 maj 2000*

## THOSHTE IM ATË

Më thoshte im atë,  
Asohere burrë i vjetër,  
Kur të dalësh nga shkolla  
Mos mbaj nga pazari,

Eja udhës tjetër.

Përse, o atë, përse?  
Djal i urtë jam e s'di të bëj sherre,  
Po rritem pa vese.

Udhës tjetër, bir!  
I pashëm je ,e zell ke për dije,  
Pazari ka njerëz çdofarësh.  
Asgjë të mos bësh,  
Të ngjesin ndonjë bisht.

Por, unë mbajta ndonjëherë  
Udhës së pazarit  
Gabimisht.

## TË JETOSH SA PËR TË VDEKUR

Dyfish

Jam dërrmish për t'u ngjitur në m

Mos mbaj nga pazari,

ajë të një suke.

Jam ngjitur e i vikas botës që e dua

Ndryshe.

Medet!

Veç dy-tre suka

Kapton zëri im i mekur.

Patjetër më duhet të dal mbi një kodër

Ose të jetoj, sa për të vdekur...

## NUK ËSHTË E THËNË

Nuk është e thënë se ti je pishtar  
Vetëm se gris kohën nën hijen e një pishe,  
Nuk është e thënë...  
Me atë gjuhëz flake që mban në dorë  
Një çerdhe zogu ke djegur  
(Kushton më shumë se një pishnajë)  
E ç'mund të bësh tjetër,  
Kur krojet e dhimbjes rrjedhin rrëkajë  
Udhëkryqit në terr?

## LUMI MALL

Tre prille vonuan të vinin  
Vonoj bari të mbijë e lulja t'hapë fletën  
Liqenet ngurruan të shkrinin.  
Tre prille në Lurë nuk erdhën...

Legjenda thotë: lurasit ikën n'vrrri  
Me kokën gjysëmkthyer nga trojet.  
Bornaja, bjeshknaja u nxi  
Dhe lot pikuan krojet.

E loti ndër lugje rrodhi rrëkajë  
Prilli vendosi në mal të dalë.  
Bjeshka nga pritja shtrydhi gjoksin. Pastaj  
Nga gjinjtë i rrodhi një lum' me mall

Lurasit u kthyen me prillin bashkë  
E tek carani rindezën zjarrë.  
Pastaj tek lumi fytyrën e panë  
E që atëhere, lumit i thërrasin: Mall.

## PËR KUAJT

Ndër luftrat e rrepta në Trojë e Spartë  
Në fushë të Torviollit a në Valkal  
Nuk dihet as sot sa kalorës u vranë  
Veç një gjë dihet: luftonin mbi kalë.

Në vend të kalorësit në fushëluftë  
Ndodhte shpesh që kafshës fisnike  
T'i ngulej heshta në mishin e butë  
Para atij që sipër i rrinte...

Në brraka gjaku nuk ngordhte, por vdiste  
Në pikun e zulmës, nën harqet e zjarrtë  
S'mendonte kush, një grusht dhe t'i hidhte  
Ndërsa i zoti merrte urdhërin e lartë...

Kur njerëzia shpiku armën e zjarrit  
Dhe armët e helmit i shpiku,  
U dasht prapsepapë shërbesa e kalit  
(Të ngratit kalë s'iu nda rreziku)

Kalorës që krekoseni mbi kuaj shaluar  
Se u varen këmbët, s'qaj dertin tuaj  
Çuditë me kuajt, si munden me duruar  
Pa iu shemb përdhe. Çuditë dhe vuajt...

## ...KA 100 VJET

Shtatë gurra të ngrohta gjaku  
Rrodhën mbi akull.  
E Shpella e Akullit nuk u shkri  
As gjaku nuk u ngri...  
...Ka 100 vjet

Shtatë mangore gjakëlyer t'shkyme me thikë  
Mbi shtatë shkëmbinj të bardhë dridhen...  
E era veriore s'ka mund me i tha  
As kroi i bornajës s'i ka la...  
...Ka 100 vjet.

Shtatë këngë majekrahu  
Si shtatë këmbana që thërrasin lirinë  
E Shpella e Akullit jashtë shpalos lavdinë  
Si flamuri i madh për shqiptarinë...  
...Ka 100 vjet.

Shtatë e shtatëmijë gurra të ngrohta gjaku  
Rrjedhin e djegin mbi akull.  
E akulli i Ballkanit nuk shkri  
As gjaku nuk mundet me ngri...  
Ka 100 vjet.

## DHURATA

Ka qënë fati im i lig  
Që ndër ditë kam shtruar tërkuzën vetë,  
E kam mbajtur barrën e të tjerëve  
Si çirak i shkretë.

Ka qënë dhuratë e Zotit  
Që qetësisht të sulmoj me heshtjen  
Gënjeshtrat t'i lë të grinden fort  
E t'përgënjeshtrojnë vetveten ...

## NJËHERË...

Një herë më mori jeta përdore  
Përballë më dolën shtigje të zëna,  
Dielli nuk më ngrohte,  
Më përvëlonte  
Hëna.

## REKUIEM

Më dritëronin sytë kah binin ylbere  
Ecja në një shteg dimri me një këngë pranvere.

Unë isha i njomë dhe ti krejt e re  
Shekulli i njëzetë- viti shtatëdhjetë e tre.

Seç po vjen nga Lindja, fryn një erë e ftohtë  
Mbi qerpikë më ngriu, lotin tim të ngrohtë.

Fillimin e këngës, oh! Ç'ma thanë në buzë  
Si ta ktheja brengën në një aktakuzë!?...

Errëtonin sytë ,s'shijja më ylbere  
Se më prenë gjarpërinjtë shtegun e një ëndrre

Unë isha i njomë dhe ti krejt e re  
Shekulli i njëzetë - viti shtatëdhjetë e tre.

## SFIDË PIJETARI

Rreshtuar gotat në banak  
Si ushtarë të bindur, besnikë të vjetër  
I kam thyer me dufin zemërak  
Si pijetar i krisur, i etur...

Më poçin e verës "Kallmeti "  
E koranin e skuqur, a të pjekur,  
Me miq bujarë e trille poeti  
Agu, rreth tavernës na ka gjetur

Sypërskuqur, qepallërënduar  
Nga mospërplasja tek bëj kujdes  
Më duket se atëbot më kanë rrethuar  
Rusi Esenin e Bërnsi skocez

Tutje më shfaqet mbreti i Tules  
Ma tund putirin babaxhan  
- S'ta kam zili atë kupë ari,  
Unë rakinë e pi dhe me filxhan .

Ty mikja të fali një shenjë t'magjishëm  
Mua gruaja më solli n'jetë tre fëmijë,  
Trashigimtarët e mi të ligjshëm,  
Pa asnjë trashigimi.

## DHE PRAP M'U SHFAQ NJË FYTYRË E VERDHË...

Kur dimri të kishte lodhur  
E trupi të kishte mardhur  
Si i thonë fjalës së moçme  
Kishe rënë nën udhë,  
Të pashë me sytë e dhëmsuruar  
Me guximin e luftëtarit  
Dorën ta dhashë  
I rashë fort lakut të litarit  
E të thashë:  
    - Merr frymë i lirë,  
Ndiq hapin e shtegtarit,  
    - Zoti ta bëftë mirë!  
Ata që më panë më thanë:  
    Bëre vërtet shumë  
T'i japësh dorën atij që gremiset  
Nuk është njëllor si t'i futish bërrylin  
E t'a plandosësh në lumë...  
... dhe prap m'u shfaq një fytyrë e verdhë  
Nga fundi i theqafjes m'u shfaq sërish  
Me trupin dërmish e krejt i mjerë  
Ai që dorën i dhashë ish.  
Mallkova vetveten:  
- Ta lightë Zoti orën  
Kotsëkoti , pse bën mundim  
Nuk është mirë t'i japësh dorën  
Atij që veç te poshtën din...

## PELENA E BARDHË...

Kur ai erdhi në këtë botë,  
Herën e parë  
Mbi supe i hodhën  
Një pelenë të bardhë`  
Dhe thanë:Pastë fat të mbarë!

Gjatë foshnjërisë nuk e kurseu kurrë  
T'a njolloste me spirë e t'a kalbte me shurrë  
Në fëmijëri t'a njomte me qurra  
Në rini t'a mbante si nënkresë...

Kur u ngjit tek fjala "burrë"  
Pelenën e bardhë e ktheu në flamur...

## SOT

Gjithë ditën kam pi  
Vetmuar pranë një gote,  
Të mbushur me vetmi,  
Nga mungesa jote.

## VAJZËS ME EMRIN E NJË LULEJE

Ai maji çeli shumë lule,  
Por botës s'i hynin në sy  
Pranvera me pekule  
Të priste ty  
Për të shpallur  
Kryelule.

## SONTE

Sonte  
Nuk e dua qiellin ngjyrë jargavani  
Siç e duan të gjithë poetët,  
Prushin e trëndafilite, ndezur tek mollëzat e tua ,  
S'e dua,  
Më pëlqen vetëm tek fletët,  
S' më hyjnë në punë vegimet e Dante Aligierit.  
Ç'më duhet ç'i rrëfeu Beatrices këtu e shtatë shekuj  
S'më joshin lirikat e Serembe arbëreshit  
Për strigaren e bukur - meteor i djegur.  
Valët e lumit luajnë një romancë  
E s'më qetojnë,  
S'më qeton poetika ku rrjedh një krua  
Desha në këtë qytet një vajzë  
Sonte,  
Të besonte që e dua.

## ASGJË, APO... TMERR

Në zagushinë e gushtit  
buroi një krua.  
Gurët e zallit, për një lot uji të përvëluar  
parandjejnë shirat.  
Kroi që sa buroi,  
Kur të tjerët zënë  
e shterrin,  
mbi supet e maleve grishi  
Ylberin.  
Vjeshta  
mbi afishet e blerta  
derdhi akuarelin.  
Bubullimat  
sollën shirat,  
U mbushën krojet  
dallgëzuan prrojet, liqenet blu...  
Asgjë gjer këtu.

...

Kroi që nisi të burojë në fundverë  
Në pikun e shirave u shterr  
Asgjë, apo tmerr

## BRISHTËSI

Në burgun ku i ati vuajti dhjetë vjet  
I dënuar për dy fjalë goje  
I biri i ish drejtorit është drejtor  
I biri i ish të burgosurit, roje.

## MINATORËVE TË KURBNESHIT

Mineral nxorrët, një jetë  
Florinj, ishit ju vetë.

## TË RËNËVE ANTIKOMUNISTË

Rininë e falët për një botë tjetër  
Kurora e lirisë ka lule më tepër.

## GRYKA E SELITËS

Gryka e Selitës  
Brigjet xhevahire,  
Edhe djep i blertë,  
Edhe grykë martine

Mespërmes Uraka  
Lumi syqiellor  
I derdh valt' e flakta  
Si lot vajzëror

Ndër guva, ndër shpella  
Rrëmbyer, potershëm  
Gjarpëron Shutrrea,  
Lumi i nëndheshëm

Duke murmuruar  
Dy lumenj në shtat,  
Grykë e mrekulluar,  
Paske qenë me fat!

Shpatet përkarshi  
Me tri bjeshkë mbi supe  
Ku dësh lulja e bardhë  
Kryezonja lule

Gurra nën lajthi  
Ëmbël shushurijnë  
Thua se Vivaldin  
Luajnë në çdo stinë.

Gryka e Selitës  
Akull e blerim  
Kënga edhe brenga  
E djepvarri im.

## NË SHËNGJIN

*Tim biri*

E mësove notin në lumenj që rrjedhin nga bornaja  
Në shtratin e gurtë e në shkullmat e ftohtë,  
Në pellgjet e thella e në hepet e mëdhaja  
Rrëshqisje nëpër ujra, vrulltas si një troftë.

Bukur noton ndër valët e detit  
Në liqenin e Ohrit a të Shkodrës,  
Por në detin e nëndheshëm të qytetit  
Je notari më i dobët i botës.

E, nëse jeta pa mëshirë prej teje kërkon  
Notin nëntokësor ta mësosh, sidoqoftë  
Në ujanën e turbullt ku rrjedha mungon  
Harro se je delfin, harro se mund të jesh troftë...

Im bir noton bukur në Shëngjin.

## KOMIT

Do dal komit, në mal do dal  
Pa gjerdan e bomba në brez  
Të shtrihem mbi bar e kokën të mbështes  
Mbi një gurgac e t'mos bëhem i gjallë

Kur nata të end mantelin e zi  
Do të futem në shpellë i vetëm  
Të piqem me kafshën më të egër  
Teksa të ndez një qiri...

-Pa qasu, t'i them një ujku të etur  
Të rrëfhem me mirësi  
Ata që m'rrethojnë, s'janë më pak të egër ...

Por ti do m'kuptosh, unë e di,  
Do bëhesh më i butë se do njerëz  
Grabitqarë, që ta kalojnë edhe ty.

## SHTËPIA E LASGUSHIT

U zgjua lagjja e varfër  
Në kërthizë të kryeqytetit  
Nuk u beson syve në këtë mëngjes të hirtë  
I mungon pjesa e saj e florinjte  
Shtëpia e poetit...

Tek ajo shtëpi përtrollëse  
Kishte hyrë Gëtja e Pushkini,  
Robert Bërnsi, Eminesku...  
Hynin duke ligjëruar me gjuhën e nënës së tyre  
Dilnin duke kënduar me fjalët e poetit...

Ajo nuk është më,  
As varri i qenushit të tij.  
Një valë liqeni dremit në sytë e mij  
Ani se brenda meje, kahmot  
Lasgushi ka ngritur një shtëpi  
Bekoje, o Zot!

*Prill 2004*

## ËSHTË NJË MOLLË NË KURBNESH...

Është një mollë në Kurbnesh  
Me një rën anë prej motesh të tharë  
(Bash ajo anë, ku fruta shpesh  
Me ty kemi marrë).

Në asnjë degëz lule më nuk çel  
Molla e moçme anës udhës,  
Por aroma e frutave edhe sot më dësh  
E tjetër ritëm i jep zemrës...

Është një mollë në Kurbnesh...

## ME ZËRIN TËND

Në djalëri më thoshte një zog  
Me zërin tënd seç më thosh:  
-Pa ty lumenjtë, qytetet , vetë kjo botë  
Nuk janë gjë tjetër, veçse një bosh...

Një shkrepimë e bardhë na ra në mes  
Dhe na dogj...  
Pa mua bota, nuk ish më “një bosh”...

Në djalëri më thoshte një zog  
Me zërin tënd...

## MË “GRISH” NJË SHPELLË

Ma gjej një gëzof të trashë  
Sa pëllëmba e një burri,  
Ma gjej pash qumështin e nanës  
O vëlla, o mik!  
Po më dridhet mjekrra në këtë mesditë me diell.  
Ky fundkorrik po çartet prej ngricave...

Një gëzof të trashë, bre njeri !  
Përdhunshëm po “më grish” një shpellë  
E thellë , e thellë,e thellë...  
Ku akulli nuk shkrin asnjëherë  
Ku hyn i bardhë e del i verdhë  
Ku hyn i gjallë e s’del as i vdekur...

Një gëzof të trashë!  
Mbi një fije të hollë,të hollë  
Dita po var shpresën time të lodhur.  
Heu, ku-ku!...

## RËNIA E MINATORIT

Ora ishte dhjetë.  
Horizonti dyzet, galeria pesë  
Ai ra.  
Nuk ndërroi jetë  
Ashtu thjeshtë.

\*\*\*

Poshtë gurëve duroi si guri  
Duroi derisa duart e shokëve rrufeshëm  
Shtatin e përgjakur e ngritën peshë  
E krejt sy e veshë  
Shihnin si skuqte currili i gjakut  
Ndjenin sypërlotur rrahjet e fundit të zemrës...

Nuk rënkoi.  
Nuk mundej më.  
Pastaj nën shiun e gjakut shokët e besuan  
Kishte rënë...

\*\*\*

Nëntokasit mbi supe e nxorën mbi tokë  
Të nesërmen në tokë e kallën përsëri

Ai ra.  
Nuk ndërroi jetë ashtu thjeshtë.  
Gazetat nuk thanë asnjë fjalë.

“Heronjtë” ishin gjallë...

## TË RËNËT PAS BETEJËS...

Fituan betejën, me minierën  
Humbën betejën, me vdekjen...

## DHORË, MOJ DHORKË E VOGËL

Të mbaja pranë, si mbahet një motër  
Të prushonin mollëzat, Dhorë, moj Dhorkë e vogël

T'flisja për shkrimtarë, flijsa për poetë  
Në dy sy bojë qielli, t'hajnoi një sekret...

Përmbi kurba valësh lozte një pulëbardhë  
Ti edhe ajo, si perlat mbi valë...

Deti leshterikët sillte mbi tallaz  
Trok' i hapit tënd, bregut më ndjek pas.

Ç'i hip atij kali ngarkuar me ëndrra  
Mos i thuaj ushtarit, atë që t' thotë zemra!

Zbres nga Mirdita, nga bjeshkët vij unë  
Kur shkrep syri i çikës, ndizet një furtunë

Eci përgjatë bregut, deti ka tallaz  
Ç'ke ,moj Dhorkë e bukur, përse më ndjek pas?!..

T'a lexoj sekretin në dy sy bojë qielli  
Më don një vajzë fshati moj, porsi dritë dielli...

Të mbajta pranë, të desha si motër  
Ç'e lëndove zemrën, Dhorë, moj Dhorkë e vogël!...

## BIRI I HORRIT

Në zyrë m'erdh si shpèz' e trembur  
Biri i horrit,  
Ballërrudhur,ftyrvrejtur  
S'flet prej zorit...

I shkolluar, i lavdëruar  
Fisnik djalë  
Pa fillon me ligjëruar  
Dalëngadalë:

-Ju e dini,vij nga larg  
Nga kryeqyteti...  
Dhe e di si t'u nxi jeta  
Prej tim eti.

Po im atë...i dha fund jetës  
Qysh në gjallje,  
Burrëroi n'emër të vërtetës,  
Kërkoi falje...

Dhe kujtova , harrova e mendova  
Qetësisht.  
I dhashë dorën,ja shtrëngova  
Burrërisht.

Mora penën,hodha firmën  
Përmbi letër  
Biri i horrit, s'ishte horr,  
Ishte tjetër...

## PO VJEN

-Kujtimit të mikut tim, Kolin Gjoka -

U pik një yll nga qielli blu  
U ngjit një engjëll në qiejt e nalta  
Shkëlqejnë do gjurmë në udhën e nisur  
Të rrokopujshme siç e la nata...

E vogël fort vatra prindërore  
Supet e shokëve janë krejt të brishtë  
Të mbajnë malin e dhimbjes njerëzore  
Në këto çaste të trishtë...

...

Ai po vjen,po vjen, po vjen  
A nuk e shihni xhevahirin?!..  
Dheu i tokës që aq fort e deshi  
S'e tret floririn...

## E PASHË NËNËN NË ËNDËRR...

E pashë nënën në ëndërr  
Veshur me petkun mortar  
Dhembja më therte në zemër  
Thikë në kraharor...

Trishtuar u zgjova në mesnatë  
Përtokë nënkresën e flaka  
Drejt nënës , jermuar vrapova  
S'kisha flatra  
Të ngjitesha ku rron ajo,  
Në qiejt e larta...

## I BUKUR!

Me danga në kyçet e duarve  
Ku tringëlluan zingjirët e tiranit,  
Me rrudha të thella nga dhimbja e thellë  
Me fytyrën –limon i prerë  
Me gjurmët e shkopinjve në shtat  
I kërrusur,  
Por, kurrë i përkulur  
I bukur!

## DRITË FERRI...

Ditënata i fiku fenerët,  
Dhe ja:na rrasën në odën e errët  
Ku gishtat në sy ia kallim njani-tjetrit  
Mos! Mos thuaj këtu s'ka dritë!  
Është drita e ferrit...

## PËRRALLA TË VËRTETA PËR TIM BIR

Bir, sipas teje , të rrëfeva do përralla  
Që s'kanë të bajnë me Ali Babën  
Vëllezërit Grim do i çmonin “të rralla”  
E s'do t'i gjenin, po t'pysnin tërë botën.

Ali Baba i njëmijë e një netëve,  
Anderseni e të tjerë,e të tjerë  
Kanë përrallisur për bëmat e kafshëve e njerëzve,  
Por , të verteta si këto, nuk kan tjerë...

E, s' është fjala për të fajësuar  
Pararendësit tanë mendjendritur  
Veç, në rininë time po t' kishin jetuar  
Përralla si këto, s'do mund të kishin stisur...

N'atë stinë të çartun, të alltë  
Shekull me dy luftra botërore  
Nuk solli me pak viktima,marrëzi e plagë  
Lufta e tretë, lufta klasore.

Ti qesh me mua e mos beso,  
Quaje përrallë, të vërtetën time të hidhur  
Veç një gjë mbaj ment, mos harro  
Çdo kohë ka përrallat e veta,

Të jesh i bindur!

\*\*\*

Ti që poezinë ke për zemër  
Si nuk zure mik një poet,  
Në këtë botë tek cila femër,  
fjala poet, s'lëshoi tërmet?!...

Bijë e malit, lule fushe  
Sa herë ma grishe muzën,  
Yje mblodha nëpër muzgje  
E ndriçova udhën.

Kaq e largët paska qenë  
Kjo udhë drejt teje. Medet!  
Kur t'vij tek ti, gjethet do kenë rënë  
E , s'do ndjehem mashkull as poet...

## EPISOD NË 20-VJETORIN E RËNIES SË MURIT TË BERLINIT

Në buzë i digjet një flakëz e kuqe  
Një tufëz zambakësh zbardhon kur qesh  
Më ngjan se përpara kam një ruse  
Si ato që Pushkini gjuante shpesh...

Vazhëz e njomë me sy të kaltër  
Që flokët i kullojnë dritë hëne  
Sy për sy me rusen e largët  
E sertë, e prerë si një gjermane...

Atëbotë u them me ton hokatarë:  
Ju ngjani si Lindja ballë Perendimit  
Po unë, e mira t'ju marrë,  
Mes jush, a s'jam si Mur' i Berlinit?

Vështrimet mos i ktheni në heshta,  
As fjalët në granata,  
Mos nisni drejt meje sulmet e befta  
Si në kohët e acarta!

Ato qeshin me njëra tjetrën  
E më përgjigjen pernjëherësh:  
-Ti mur ke qenë, por dy sy të shembën,  
Shumë përpara njëzet vjetësh...

## PËRMBATJA

QËNDRESA E FAJIT	4
SHIRA DHE YLBERE	5
FATI IM	6
DURIMI	7
ÇUDI ME TY	8
FRASHËLIES	9
SHPIRTI I BARIUT	10
KROI I BARDHË	11
TE SUKA E GJOLLËVE	12
KLITHMA E HESHTJES SË BARDHË	14
PROTOZOT	15
NUK ISHTE VJESHTË	16
PESHA	17
THOSHTE IM ATË	18
TË JETOSH SA PËR TË VDEKUR	19
NUK ËSHTË E THËNË	20
LUMI MALL	21
PËR KUAJT	22
...KA 100 VJET	23
DHURATA	24
NJËHERË...	25
REKUIEM	26
SFIDË PIJETARI	27
DHE PRAP M'U SHFAQ NJË FYTYRË E VERDHË...	28
PELENA E BARDHË...	29
SOT	29
VAJZËS ME EMRIN E NJË LULEJE	30
SONTE	30
ASGJË, APO... TMERR	31
BRISHTËSI	32
MINATORËVE TË KURBNESHIT	32
TË RËNËVE ANTIKOMUNISTË	32
GRYKA E SELITËS	33
NË SHËNGJIN	35
KOMIT	36
SHTËPIA E LASGUSHIT	37

<i>ME ZËRIN TËND</i>	38
<i>MË "GRISH" NJË SHPELLË</i>	39
<i>RËNIA E MINATORIT</i>	40
<i>TË RËNËT PAS BETEJËS...</i>	41
<i>DHORË, MOJ DHORKË E VOGËL</i>	42
<i>BIRI I HORRIT</i>	43
<i>PO VJEN</i>	44
<i>E PASHË NËNËN NË ËNDËRR...</i>	45
<i>I BUKUR!</i>	46
<i>DRITË FERRI...</i>	46
<i>PËRRALLA TË VËRTETA PËR TIM BIR</i>	47
<i>***</i>	48
<i>EPISOD NË 20-VJETORIN E RËNIES</i>	49



